



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr. 79, date 1.10.2018

PËR

**“PËRCAKTIMIN E SIPËRMARRËSIT VODAFONE ALBANIA SH.A ME FUQI TE
NDJESHME NË TREGUN ME SHUMICË TË AKSESIT DHE ORIGJINIMIT,
TREGUN ME SHUMICË TË TERMINIMIT TË THIRRJEVE NDËRKOMBËTARE
DHE TREGUN ME PAKICË TË SHËRBIMEVE CELULARE DHE MASAT
PËRKATËSE RREGULLATORE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Zj. _____, në mbledhjen e datës _____.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a me Fuqi te Ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore”

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore i cili përbëhet nga:

- i. Projekt vendimi;
- ii. Relacioni Shoqërues (Relacioni);
- iii. Dokumenti: *“Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë i aksesit dhe i origjinimit ne rrjetet celulare, tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar”*.

BAZA LIGJORE:

- 1) Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
- 2) Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
- 3) Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike;
- 4) “Rregullore për analizën e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, të Këshillit Drejtues të AKEP, ndryshuar me VKD nr.2342, datë 31.07.2013 (*Rregullorja*).
- 5) Vendimi Nr.16 datë 22.02.2018 “Për *Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare - Këshillim publik”*”
- 6) Vendimi nr.78, datë 1.10.2018 për “*Miratimin të Dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar”*”

KESHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-vendimi për “*Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a me Fuqi te Ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore*”;
2. Dokumenti: “*Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar*”;
3. Relacioni shpjegues për Projektvendimin (*Relacioni*).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V E R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.16, datë 22.02.2018, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë i aksesit dhe i origjinimit ne rrjetet celulare, tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, tregu me pakicë i shërbimeve celulare–Këshillim Publik*”. Dokumenti i analizës u publikua në faqen e internetit të AKEP dhe periodha e këshillimit publik sipas përcaktimeve të ligjit 9918 ishte 60 ditë, 26.02.2018 – 28.04.2018.
2. Pas përfundimit të këshillimit publik, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendim Nr.78, datë 1.10.2018, ka miratuar dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë i aksesit dhe i origjinimit ne rrjetet celulare, tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar*”, dokument i cili:

- a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 26.02.2018 – 28.04.2018, dhe përmban komentet e palëve të interesuara, përfshirë komentet e Vodafone Albania, dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 1, i dokumentit) në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
 - b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatorë dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - c. nga pikëpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.9918/2008 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
 - d. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës dhe analizën e testit të tre kritereve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet për FNT;
 - e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
 - f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.
 - g. përmban arsyetimin dhe përfundimin se Vodafone Albania sh.a përmbush kriteret për FNT në tregjet përkatës të analizuar: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare, tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare;
 - h. përmban arsyetimin dhe detyrimet e vendosura për FNT të Vodafone Albania, të cilat janë në përputhje me përcaktimet e nenit 36 të ligjit 9918 dhe bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe janë proporcionale e të justifikuar nga pikëpamja e objektivave rregullatore të vendosura në nenin 7 të ligjit 9918.
3. Dokumenti “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë i aksesit dhe i origjinimit në rrjetet celulare, tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar*”, miratuar me VKD Nr.____, datë _____.2018, shërben si bazë arsyetuese për marrjen e vendimeve për statusin me FNT në tregjet e analizuar, dhe masat rregulluese për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a të përcaktuar me status me FNT.

A T E H E R Ë:

Për sa më sipër, mbi bazën e vlerësimit të fuqisë së ndjeshme të sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a, sipas dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë i aksesit dhe i origjinimit në rrjetet celulare, tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar*”, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Bazuar në dokumentin “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë i aksesit dhe i origjinimit në rrjetet celulare, tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar”, miratuar me VKD Nr.78, datë 1.10.2018, të përcaktojë sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.A., sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg në tregjet përkatës të mëposhtme:
 - a. *Tregu me shumicë i aksesit dhe i origjinimit në rrjetet celulare;*
 - b. *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare; dhe*
 - c. *Tregu me pakicë i shërbimeve celulare.*
2. Sipërmarrësit e Vodafone Albania sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe i origjinimit në rrjetet celulare (pika 1/a më sipër), është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet e parashikuara në Ligj si më poshtë vijon:
 - 2.1. Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 9918/2008;
 - 2.2. Detyrimin e transparencës, sipas nenit 40 të ligjit nr. 9918/2008;
 - 2.3. Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918/2008;
 - 2.4. Detyrimin për kontroll të tarifave, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9918/2008;
 - 2.5. Detyrimi për ndarjen e llogarive(neni41).
3. Detyrimet e mësipërme në pikën 4, përfshijnë:
 - 3.1. **Detyrimi i mosdiskriminimit (Neni 39)**
 - i) Sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.a., të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t’u ofrojnë sipërmarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij. Vodafone Albania ka detyrimin të mos diskriminojë në lidhje me aksesin, me çmimin ose ndonjë kusht tjetër për akses për roaming kombëtar, akses për operatorët virtualë celularë (MVNO), origjinim të thirrjeve dhe shërbime të tjera me shumicë që shërbejnë si inpute për ofrim të shërbimeve në tregun me pakicë për operatorët e tjerë.
 - ii) Sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.a.,:
 - (1) të përditësojë Ofertën Referencë të Interkoneksionit, për ta përshtatur me ndryshimet dhe nevojat e tregut brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimit të përfshijë në RIO shërbimet e origjinimit të thirrjeve drejt numrave të ofruesve të thirrjeve me karta të parapaguara (OSHKP) dhe numrave pa pagese 0800xxx, përfshirë tarifën perkatese;
 - (2) të publikojë Ofertë Reference Aksesi për shërbime të MVNO-ve kur ka një kërkesë të arsyeshme për këto shërbime;
 - iii) Sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.a., të publikojë marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesore të Performancës (Key Performance Indicators -KPI) për aksesin dhe origjinimin sipas përcaktimeve të Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit.

3.2. Detyrimi i transparencës (Neni 40);

Oferta Referencë e Interkoneksionit e përditësuar dhe Oferta Referencë e Aksesit nga Vodafone Albania Sh.a sipas pikave ii.1 dhe ii.2 më sipër për të përfshirë dhe

shërbimet e aksesit dhe origjinimit duhet të përshijë informacionin e mëposhtëm të nevojshme për akses në rrjetin Vodafone Albania Sh.a:

- i) Specifikimet teknike;
- ii) Karakteristikat e rrjetit;
- iii) Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- iv) Tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

3.3. Detyrimi për akses dhe interkoneksionit dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);

Sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.a., për aksesin dhe origjinimin e thirrjeve në rrjetin celular, duhet:

- a) të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palët e treta;
- b) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- c) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- d) të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;
- e) të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët
- f) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose roaming-ut në rrjetet mobile;
- g) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;
- h) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit;
- i) të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese.

Detyrimet e mësipërme për akses i referohen vetëm dhënies së aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetin celular Vodafone Albania, dhe janë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a, si edhe me tarifa të cilat mbajnë paarsyesh investimet e kryera dhe një normë të arsyeshme fitimi.

3.4. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto (neni 45)

- i) Tarifat e aksesit dhe origjinimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me këto shërbime në rrjetin Vodafone Albania janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP;
- ii) Metoda e rregullimit të tarifave të shërbimeve në piken 'i' më sipër përcaktohet me vendim të veçantë nga AKEP, sipas përcaktimeve të nenit 55 e në vijim të Ligjit 9918.

Parimi i rregullimit të tarifave lidhet me testin margin squeeze e rregullimit të marzhit apo diferencës midis tarifave mes shumicës dhe pakicës dhe testin e replikueshmërisë ekonomike, të sugjeruar nga KE në rekomandimin 2013/466/EU. Masat rregullatore duhet të garantojnë që marzhi midis tarifave me shumicë dhe me pakicë është i mjaftueshëm që të krijojë hapësirë për operatorët e tjerë të konkurrojnë, dhe me një fitim të arsyeshëm, pra që do thotë që operatori me FNT nuk duhet të kufizojë konkurrencën, nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta të paarsyeshme (në nivel me shumicë) ose tarifave të ulëta të paarsyeshme (në nivel me pakicë);

3.5. Detyrimi për ndarjen e llogarive (neni41)

- i. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a. ka detyrimin për të pasqyruar deri në hollësi kostot dhe tarifat e shumicës dhe tarifat e transferimeve të brendshme si dhe të paraqesë në AKEP të gjithë informacionin dhe dokumentacionin shoqërues të kërkuar nga AKEP. Ndarja e llogarive do të sigurojë bazën për verifikimin e ndalimit të diskriminimit të çmimeve ndaj ofruesve të MVNO dhe ofruesve që blejnë roaming kombëtar.
 - ii. Llogaritë dhe dokumentacioni shoqërues të kërkuar nga AKEP do të dërgohen në AKEP në fund të çdo gjashtëmujori. Informacioni do të përmbajë një përshkrim të sistemit për mbajtjen e llogarive të veçanta, duke përfshirë një pasqyrë të kategorive të kostos dhe alokimi kryesor i shpërndarjes që përdoret.
4. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT në *tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare* (pika 1.b më sipër), është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet si më poshtë:
- 4.1. Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 9918/2008;
 - 4.2. Detyrimin e transparencës, sipas nenit 40 të ligjit nr. 9918/2008;
5. Detyrimet e mësipërme në pikën 4, përfshijnë:

5.1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)

Sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.a të zbatojë kushte të njëjta tregtare, çmime të njëjta në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, të cilëve Vodafone Albania u ofron shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Vodafone Albania.

5.2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)

Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a. ka detyrimin të depozitohet në AKEP mbi baza tremujore dhe vjetore, dhe sipas kërkesave specifike të AKEP, informacionin e mëposhtëm:

- a. Marrëveshjet e lidhura për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Vodafone Albania;
 - b. Tarifat e terminimit të thirrjeve ndërkombëtarë të aplikuara, përfshirë uljet;
 - c. Të dhëna për trafikun, të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare;
 - d. Të gjithë informacionin e mësipërm për marrëdhëniet kontraktuale me secilin operator vendas dhe të huaj.
6. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT në *tregun me pakicë të shërbimeve celulare* (pika 1/c më sipër),

6.1 Sipërmarrësi Vodafone Albania është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet e veçanta sipas nenit 56, si më poshtë:

- i. të mos zbatojë tarifa tepër të larta;
- ii. të mos pengojë hyrjen në treg të lojtarëve të rinj;
- iii. të mos kufizojë konkurrencën, nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta të paarsyeshme ose tarifave të ulëta të paarsyeshme;
- iv. të mos shfaqë parapëlqime të diferencuara ndaj përdoruesve fundorë të veçantë;

v. të mos ofrojë paketa të paarsyeshme shërbimesh.

- 6.2. Për një periudhë jo më vonë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, AKEP do vlerësojë efektet e masave të parashikuara në pikën 3.4 të këtij vendimi sipas parashikimeve në nenet 39 deri 43 të këtij ligji. Nëse konkludon se këto masa nuk janë të mjaftueshme, AKEP-i ka të drejtë të vendosë detyrimin për rregullimin e tarifave në këtë treg përkatës, sipas nenit 57 të këtij ligji duke nxjerrë vendimin për rregullimin e tarifave si vijon.
7. Dokumenti “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë i aksesit dhe i origjinimit ne rrjetet celulare, tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar*” i bashkëngjitet këtij vendimi si Aneks 1 dhe është pjesë e tij.
8. Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT për sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.a. në tregun përkatës referuar në pikën 1 të këtij vendimi, është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut të kryer sipas nenit 34 të Ligjit 9918.
9. Ky Vendim të publikohet në faqen zyrtare të internetit të AKEP: www.akep.al
10. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir ZELA

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Edlira DVORANI**
- 3. Ketrin TOPÇIU**
- 4. Klarina ALLUSHI**